



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I STATISTIKËS DHE
INFORMATIKËS SË ZBATUAR



Miratoi

Prof. Dr. DHORI KULE

Dekan

Program Mësimor

Lënda: Komunikim i të Dhënave në Biznes

Programi i Studimit: *Master Profesional në Degën Sisteme Informacioni në Ekonomi, kohë e plotë.*

Viti Akademik: 2017-2018

Semestri i parë

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Dr. Kozeta Sevrani

Janar, 2017

Pedagogu: Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli/ Elda Kuka

Adresa Elektronike e pedagogut të lëndës në FEUT: ezmolda.barolli@unitir.edu.al
ezmoldabarolli@feut.edu.al, eldakuka@feut.edu.al

Ngarkesa: 6 ETCS, 4 Orë në javë; 2 (Leksion), 2 (Seminar)

Semestri: I

Lloji i lëndës: e detyrueshme

PËRSHKRIM I LËNDËS:

Komunikimi i të dhënave është një fushë shumë interesante për karrierën e tashme dhe të ardhme të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe sigurisë. Telekomunikimi është shtylla kryesore e infrastrukturës së TI të ndërmarrjeve të biznesit, që mundëson lidhjen midis bizneseve ose personave në mjedisin e sotëm global. Kjo lëndë ofron bazat e koncepteve të komunikimit të të dhënave, telekomunikimit, rrjetit, aplikacioneve, menaxhimit, ligjeve dhe standardeve përkatëse. Qëllimi është planifikimi, analizimi, dhe dizenjimi i një infrastrukture të sigurtë telekomunikimi që përmbush nevojat e biznesit dhe mbron asetet e informacionit. Temat përfshijnë sigurinë, komunikimin e të dhënave, protokollet dhe standardet, rrjetat, dhe tendencat në telekomunikim.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E LËNDËS:

Në ditët e sotme të diplomuarit në Sistemet e Informacionit e gjejnë veten e tyre jo vetëm në drejtime të veçanta që përcaktonin karrierën përgjatë dekadave të kaluara, të tilla si programistë, analistë bazash të dhënash, administratorë, por edhe në disa drejtime të reja si rrjetat kompjuterike dhe siguria në to. Qëllimi i kësaj lënde është që të plotësojë njohuritë e studentëve të degës së Informatikës Ekonomike me tematika që lidhen me administrimin dhe sigurinë e rrjetave kompjuterike. Objektivi kryesor i kësaj lënde është të prezantojë studentët me konceptet për rrjetat në biznes, dhe gjithashtu ti japë atyre mundësinë të praktikojnë aftësitë duke përdorur aktivitete në laborator.

Në fund të kursit studenti duhet të jetë i aftë të:

- Kuptojë terminologjinë bazë të rrjetit;
- Kuptojë arkitekturat kryesore të standardeve: TCP/IP, OSI dhe arkitekturat hibride;
- Kuptojë ciklin Plan-Mbrojtje-Përgjigje për menaxhimin e sigurisë;
- Shpjegojë konceptet e përgjithëshme në menaxhimin e rrjetit;
- Shpjegojë diferencat në shërbime dhe kosto të LAN-ve dhe WAN-ve;
- Përshkruajë teknologjitë wireless LAN;
- Përkufizojë adresat hierarkike IP;
- Shpjegojë teknologjitë e përdorurara në WAN-e.

METODOLOGJIA E MËSIMIT DHE MATERIALET E KURSIT

Në këtë seksion përmenden metodat e mësimdhënies që do të përdoren në këtë kurs, duke përfshirë leksionet, seancat e ushtrimeve dhe diskutimeve në seminare, si dhe prezantimin e diskutimin e materialeve të marra nga literatuara. Studentët pritet që të luajnë një rol aktiv në diskutimet në klasë dhe seancat e zgjidhjes së problemeve.

Leksionet dhe Seminaret

Materiali bazë për kursin do të jenë leksionet dhe seminarët në klasë (shënimet e studentëve), prezantimet powerpoint të përdorura nga lektori për secilin leksion, të shoqëruara me referencat në literaturën bazë. Mësimi do të jetë interaktiv. Gjatë zhvillimit të seminareve theksi vendoset në përsëritjen, kuptimin logjik, konsolidimin e njohurive teorike të marra në leksione dhe mbi të gjitha zhvillimin e aftësisë për zbatimin praktik të tyre nëpërmjet zgjidhjes dhe analizës së problemeve të ndryshme.

Teste dhe Punë Individuale

Detyra shtëpie në formën e ushtrimeve, problemave apo rasteve të studimit do të jepen për të ndihmuar studentin që të përvetësojë materialin e kursit dhe të përgatitet për provimin. Rastet e studimit do t'ju japin studentëve mundësinë që të ushtrohen dhe përmirësojnë aftësitë e komunikimit me shkrim ose verbal nëpërmjet prezantimeve në klasë. Teste të rastësishme do të organizohen për të lejuar pedagogët të kuptojnë progresin e kursit. Komunikimi interaktiv në formë elektronike do ti orientojë tek shumë materiale dhe burime të tjera informacioni. Materiale online ndihmëse për t'u përgatitur për kursin përfshijnë prezantimet powerpoint, ushtrime të zgjidhura dhe të pazgjidhura etj.

Komunikimi me Studentët dhe Konsultimet

Komunikimi me studentët do të realizohet në klasë si nëpërmjet diskutimeve ashtu edhe ushtrimeve për të testuar se sa i kanë kuptuar materialet e kursit. Studentët mund të komunikojnë gjithashtu me pedagogët e lëndës gjatë orareve të caktuara për konsultim. Nëse gjatë zhvillimit të kursit do të kenë ndonjë pyetje, apo do të kenë nevojë për ndihmë individuale, mund të kërkojnë një takim në një nga oraret e konsultimit të shpallura.

Frekuentimi

Frekuentimi i leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike: është i detyrueshëm në masën 75%. Kur studenti ka marrë pjesë në 50%-75% nuk ka të drejtë të hyjë në provimin e rradhës por kalon në sezonin e vjeshtës. Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 50% të tyre, ai përsërit lëndën në vitin e ardhshëm. Detyra e Kursit është e detyrueshme për tu mbrojtur, në të kundërt studenti nuk mund të hyjë në provim.

KODI I ETIKËS

Ky kurs do të zhvillohet në përputhje me rregullat e specifikuar në Rregulloren e UT, rregulloren e FE dhe Kodin e Etikës së Fakultetit të Ekonomisë, të cilat obligojnë zero-tolerancë ndaj pandersshmërisë akademike.

VLERËSIMI DHE KONTROLLI I DIJEVE

Vlerësimi i dijeve të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm të vlerësuar me pikë (në total 100 pikë):

1. Provim i ndërmjetëm 25% - 30%;
2. Provim përfundimtar me shkrim 40% - 45%;
3. Aktivizimi dhe niveli i diskutimit, detyra kursi, projekte etj (30%), më të detajuara janë paraqitur më poshtë;
 - Detyrë Kursi (Aktivitet në Grup) - Për këtë detyrë do t'ju përcaktohet një temë për secilin grup të cilën do ta trajtojnë në formën e një detyre rreth 10 faqe dhe do ta prezantojnë gjithashtu në klasë për një kohë 15-20 minuta. (10 pikë)
 - Detyra laboratorike/Teste (Aktivitet Individual) - Detyrat laboratorike do të zhvillohen në klasë. Ato do të jenë konkretizim i njohurive që merren në leksionet teorike duke i zbatuar ato në praktikë. Për këtë do të ketë 5 detyra të tilla të cilat do të vlerësohen me pikë. (20 pikë)

Studentit i shtohen vlerësimet vjetore (të përfshira në pikën 3) n.q.s. ai merr të paktën 40% të pikëve të secilit prej dy provimeve me shkrim të përfshira në pikën 1 dhe 2.

<i>Nota 4</i>	<i>deri në 50 pikë</i>
<i>Nota 5</i>	<i>51 - 57</i>
<i>Nota 6</i>	<i>58 - 65</i>
<i>Nota 7</i>	<i>66 - 73</i>
<i>Nota 8</i>	<i>74 - 81</i>
<i>Nota 9</i>	<i>82 - 89</i>
<i>Nota 10</i>	<i>90 – 100</i>

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Cloud computing
2. Windows networking
3. Standardet e rrjetit
4. Siguria e rrjetit
5. Menaxhimi i rrjetit
6. Microsoft office visio
7. LAN-et ethernet me tela
8. Ethernet switching
9. LAN-et pa tela 1
10. Përdorimi i Xirrus WI-FI Inspector
11. LAN-et pa tela 2
12. TCP/IP internetworking 1
13. TCP/IP internetworking 2
14. Wide Area Networks
15. Aplikimet në rrjeta

LITERATURA

- **Literatura bazë:**
Raymond R. Panko, Julia L. Panko, *Business Data Networks and Security*, Ninth Edition, Prentice Hall, 2013
- **Literatura plotësuese:**
Raymond R. Panko, *Business Data Networks and Telecommunication*, Eleven Edition, Prentice Hall, 2011
Routing and Protocols Module 2 - dilbert.hig.no/jonl/ccna/routing/.
- **Faqe interneti:**
<http://www.techweb.com/encyclopedia>
<http://www.pearsonhighered.com/educator/product/Business-Data-Networks-and-Security/9780132742931.page>.
<http://wikipedia.org/>